



Syri i Vizionit



Save the Children

Thirrje për trajner/e

Kërkojmë trajner/e për mbajtjen e trajnimeve me zyrtarët e Qendrave për Punë Sociale - QPS, në këto fusha **“Procedurat e trajtimit për fëmijë të cilët janë viktime apo ushtrues të dhunës në shkollë, familje dhe rrugë”** dhe **“Zhvillimi psikologjik i fëmijës në faza të ndryshme të zhvillimit fizik”**.

Termet e Referencës

Qershor 2021

Hyrje

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë edhe më herët, që nga viti 1999, si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Që nga fillimi, motoja e organizatës ka qenë “Mendo globalisht, vepro lokalisht”, të cilës organizata i ka qëndruar besnike. Misioni i organizatës është “Zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit” dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që kryen veprime lokale bazuar në praktikat më të mira.

Informata të përgjithshme

Syri i Vizionit (SiV) në partneritet me Save the Children Zyra në Kosovë (SCiK), tash e disa vite janë angazhuar në monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, bazuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Në kuadër të këtij partneriteti, SiV dhe SCiK kanë zhvilluar projekte për të fuqizuar mekanizmat e parandalimit të dhunës, ndëshkimit trupor dhe raportimit të rasteve të dhunës në shkolla. Në kuadër të programit të mbrojtjes së fëmijës “Detyrimi ynë për të Ardhmen - Mbrojtja e Fëmijës dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijës”, është duke u punuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve të cilat për mandat kanë mbrojtjen e fëmijëve dhe ofrimin e shërbimeve sa më profesionale dhe me kohë.

Objektivi

Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një trajner/e-profesionist/e me përvojë (së paku pesëvjeçare) në ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve sociale për fëmijë, për trajnimin e profesionistëve të punës sociale në këto dy tema:

1. “Procedurat e trajtimit për fëmijë të cilët janë viktime apo ushtrues të dhunës në shkollë, familje dhe rrugë” dhe
2. “Zhvillimi psikologjik i fëmijës në faza të ndryshme të zhvillimit fizik”

Trajnimet kanë për qëllim të ngritin kapacitetet e zyrtarëve të Qendrave për Punë Sociale (QPS), me qëllim të ofrimit të shërbimeve sociale sa më profesionale dhe me kohë për fëmijë dhe familje, për të identifikuar, parandaluar, trajtuar dhe reaguar ndaj rasteve të dhunës ndaj fëmijëve dhe në menaxhimin e këtyre rasteve sipas procedurave ligjore duke mbrojtur interesin më të mirë të fëmijës.

Përfitues të trajnimit do të jenë zyrtarët përkatës nga shtatë komuna (Pejë, Prishtinë, Fushë Kosovë, Klinë, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan) në të cilat Syri i Vizionit dhe Save the Children janë duke zbatuar Programin e Mbrojtjes së Fëmijës dhe Qeverisjes së të Drejtave të Fëmijës.

Kualifikimi i nevojshëm:

- Diplomë universitare në psikologji, shkencë sociale, punë sociale, apo fusha tjera relevante të shkencave sociale (kualifikimi master dhe edukimi profesional/joformal në këtë fushë është përparësi);
- Përvojë e punës së paku pesë (5) vjeçare në ofrimin e trajnimeve dhe realizimit të tyre që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së fëmijëve, në mënyrë specifike trajtimin e fëmijëve të cilën kanë qenë viktime apo ushtrues të dhunës si dhe fazat e zhvillimit psikologjik e fizik të fëmijës
- Njohuri për standardet minimale të punës sociale në Kosovë dhe parimet e të drejtave të fëmijëve të bazuara në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve;
- Njohuri të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës;
- Aftësi të larta ndër-personale;
- Shkathtësi të larta analitike.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Nga trajneri/ja i/e angazhuar pritet të:

- Zhvillojë materialet e trajnimeve në konsultim me stafin përgjegjës të SiV-it dhe Save the Children për rishikim dhe miratim paraprak;
- Përgatisë materialet e nevojshme shtesë për trajnim për secilin trajnim (*rendin e ditës për trajnim si dhe pyetësorët para dhe pas trajnimit*) në konsultim me stafin përgjegjës të SiV-it dhe Save the Children për rishikim dhe miratim paraprak;
- Udhëheqë trajnimin me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse për *“Procedurat e trajtimit për fëmijë të cilët janë viktima apo ushtrues të dhunës në shkollë, familje dhe rrugë”* dhe *“Zhvillimi psikologjik i fëmijës në faza të ndryshme të zhvillimit fizik”*;
- Dorëzojë draft raportin narrativ të angazhimit, përfshirë objektivat, realizimin e punës, dhe të gjeturat nga pyetësorët, jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas mbajtjes së trajnimit;
- Dorëzojë raportin narrativ përfundimtar tek SiV jo më vonë se pesë (5) ditë pune pasi të ketë pranuar komentet e mundshme nga SiV dhe SCiK.

Angazhimi i trajnerit/es:

Trajneri/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me “Syri i Vizionit” nën koordinimin e Menaxherit të financave dhe administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument.

Detyrat	Kohëzgjatja
Përgatitja e metodologjisë së punës për trajnim (materialet në Poëer Point, rendin e ditës, pyetësorët para dhe pas trajnimit dhe materialet tjera shtesë të nevojshme)	1 ditë
Mbajtja e trajnimit dy ditor me zyrtarët e QPS-ve nga shtatë komuna (Pejë, Prishtinë, Fushë Kosovë Prizren, Klinë, Gjakovë dhe Gjilan)	2 ditë
Përgatitja dhe dorëzimi i raportit narrativ	1 ditë
Gjithsej:	4 ditë

Kushtet e pagesës:

Pagesa e trajnerit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, e cila do të lëshohet nga trajneri ose do të përgatitet nga SiV e do të nënshkruhet nga trajneri/ja. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të modulit të trajnimeve dhe dorëzimit të raportit narrativ përfundimtar të miratuar nga SiV.

Në bazë të ligjit të Kosovës, Syri i Vizionit është po ashtu i obliguar që të paguajë tatimin (taksa dhe pension) prej 10% të shumës bruto. Shpenzimet e ushqimit do t'i mbulojë organizatori.

Dokumentet e kërkuara dhe procedura për aplikim:

1. Kopja e diplomës universitare (ndonjë certifikatë e licencimit nga institucioni përgjegjës konsiderohet përparësi);
2. Përshkrimi i metodologjisë së punës, duke përfshirë planifikimin e procesit të zhvillimit të materialeve për trajnim dhe mbajtjen e trajnimeve, pyetësorët para dhe pas;
3. Një letër motivuese ku përfshihet përvoja e punës dhe ekspertiza që ai/ajo mund të ofrojë në fushën e trajnimeve “Procedurat e trajtimit për fëmijë të cilët janë viktime apo ushtrues të dhunës në shkollë, familje dhe rrugë” dhe “Zhvillimi psikologjik i fëmijës në faza të ndryshme të zhvillimit fizik”, apo dokumenteve të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, apo të ngjashme;
4. Një plan tentativ i punës;
5. Biografia - CV
6. Propozimi financiar*

**Oferta financiare duhet të jetë e hollësishme për secilën punë që do të realizohet, duke përfshirë, zhvillimin e modulit dhe materialet e trajnimit, mbajtjen e trajnimeve dhe shkrimin e raportit.*

Aplikacionet duhet të dorëzohen në gjuhën lokale, në formë elektronike në adresën:

info@syriivizionit.org ose office@syriivizionit.org me lëndën: **Aplikacioni për mbajtjen e trajnimit me zyrtarët e QPS-ve**, apo edhe përmes postës fizike në adresën e organizatës - OJQ: “Syri i Vizionit”, Rr. Isa Demaj, nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **02 korrik 2021, ora 17:00**.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!